



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.50

2004

21 korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4276 datë 16.7.2004	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3405
Vendim i KM nr.439, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Lezhës	3405
Vendim i KM nr.440, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Remas	3406
Vendim i KM nr.445, datë 9.7.2004	Për miratimin e tarifave të shkollave pasuniversitare (SHPU) të Universitetit Politeknik të Tiranës	3406
Vendim i KM nr.446, datë 9.7.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.601, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për dhënien e pagës së trembëdhjetë të punonjësve mësimorë të sistemit parauniversitar”.....	3407
Vendim i KM nr.447, datë 9.7.2004	Për përcaktimin e gjendjes të të sëmurit që ka nevojë për ndihmë urgjente, si dhe dokumentacioni i nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve të bëra.....	3407
Vendim i KM nr.448, datë 9.7.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e spitaleve universitare”...	3408

Vendim i KM nr.449, datë 9.7.2004	Për financimin e Urdhrit të Farmacistëve për një periudhë njëvjeçare.....	3409
Vendim i KM nr.450, datë 9.7.2004	Për kuotën e pranimit të studentëve në Universitetin Ushtarak “Skënderbej” për vitin akademik 2004-2005.....	3410
Vendim i KM nr.451, datë 9.7.2004	Për kriteret dhe masën e trajtimit financiar të ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura, kur lirohet nga shërbimi në këto forca për arsye shëndetësore.....	3410
Vendim i KM nr.452, datë 9.7.2004	Për kriteret e dhënies së kredisë për strehim ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe masën e kësaj kredie	3411
Vendim i KM nr.453, datë 9.7.2004	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Delvinës të mjediseve të ish-brigadës së këmbësorisë në Delvinë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".....	3413
Vendim i KM nr.454, datë 9.7.2004	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Laçit të mjediseve të ish-repartit ushtarak nr.1022 në Laç, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".....	3413
Vendim i KM nr.456, datë 9.7.2004	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Agjencisë për Zhvillim Ekonomik, sh.a., të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për sistemimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare.....	3414
Vendim i KM nr.458, datë 9.7.2004	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, në komunën Markat të qarkut të Vlorës.....	3415
Vendim i KM nr.459, datë 9.7.2004	Për dhënie fondi disa partive politike të reja.....	3415
Vendim i KM nr.462, datë 9.7.2004	Për lejimin e ANTA sh.a.-së, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”për pagesën e konsulentëve juridikë të përzgjedhur, për përgatitjen e analizës juridike të mbulimit të garancisë politike të riskut, të kredisë, që do të merret nga BNP Paribas Bank, për realizimin e projektit të modernizimit të trafikut ajror.....	3416
Vendim i KM nr.464, datë 2.7.2004	Për miratimin e kriterëve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	3416
Vendim i BSH nr.52, datë 14.7. 2004	Për administrimin e rrezikut të kredisë.....	3425

DEKRET
Nr.4276, datë 16.7.2004

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Ekonomisë

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të saj:
Fatime Selim Imeraj (Zeqiri)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.439, datë 21.5.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË E LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Lezhës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë).

2. Ndryshimet që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.440, datë 21.5.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN REMAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Remas, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 50 (pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 300 (treqind).

2. Ndryshimet që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.445, datë 9.7.2004

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE (SHPU) TË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 e 38 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e shkollimit në shkollat pasuniversitare (SHPU), pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në degët inxhinieri ndërtimi e përgjithshme, inxhinieri mjedisi, inxhinieri hidroteknike, inxhinieri gjeodezi dhe pranë fakulteteve të tjera të Universitetit Politeknik të Tiranës, të jenë si më poshtë vijojnë:

- | | |
|---|--|
| - Për pasuniversitarët nga personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm i shkollave të larta publike: | 75 000 (shtatëdhjet e pesë mijë) lekë; |
| - Për pasuniversitarët e tjerë: | 100 000 (njëqind mijë) lekë. |

2. Institucionet organizuese të shkollave pasuniversitare (SHPU) t’i administrojnë të ardhurat që mbledhin, sipas ligjit nr.8379, datë 19.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

3. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.446, datë 9.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.601, DATË 17.11.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE TË
SHKENCËS, PËR DHËNIEN E PAGËS SË TREMBËDHJETË TË PUNONJËSVE
MËSIMORË TË SISTEMIT PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.601, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime.
 - a) Titulli i vendimit ndryshohet si më poshtë vijon:
“Për dhënie të shpërblimit vjetor punonjësve mësimorë të sistemit parauniversitar”.
 - b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:
“1. Punonjësve mësimorë të sistemit parauniversitar u jepet, çdo vit, një shpërblim i barabartë me një pagë mujore neto.”.
 - c) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:
“2. Ky shpërblim të jepet 50 për qind në fund të vitit shkollor, duke e llogaritur mbi pagën mesatare të gjashtëmujorit të parë të secilit punonjës mësimor dhe 50 për qind në fund të vitit kalendarik, duke e llogaritur mbi pagën mesatare të gjashtëmujorit të dytë të secilit punonjës mësimor.”.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.
 3. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.447, datë 9.7.2004

PËR PËRCAKTIMIN E GJENDJES SË TË SËMURIT QË KA NEVOJË PËR NDIHMË
URGJENTE, SI DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE TË BËRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T’u jepet ndihmë mjekësore urgjente në spital të sëmurëve, që paraqiten me këtë gjendje klinike:
 - Vështirësi frymëmarrjeje të çdo tipi;
 - Humbje të ndërgjegjies;
 - Dhimbje koke, paralizë, konvulsione të rënda e të menjëhershme;

- Dhimbje ose shtrëngim të gjoksit;
- Dhimbje të menjëhershme të barkut;
- Hemoragji masive;
- Fraktura;
- Dëmtime nga përplasjet me mjete motorike ose me armë;
- Dëmtime të kokës ose qafës;
- Dehidratim të rëndë;
- Gjendje të axhitimit psikomotor.

2. Dokumentet e nevojshme për llogaritjen e shpenzimeve të bëra gjatë dhënies së ndihmës mjekësore urgjente janë:

- Kartela e shërbimit të urgjencës;
- Dokumenti i identifikimit të pacientit;
- Libreza e sigurimit shëndetësor të pacientit.

3. Këto dokumente kërkohen, plotësohen dhe verifikohen, detyrimisht, në urgjencë, pas dhënies së ndihmës urgjente. Në rastet kur pacienti nuk është i shoqëruar me familjarë, plotësimi i këtyre dokumenteve bëhet në pavion.

4. Llogaritja e shpenzimeve bëhet sipas përcaktimeve të parashikuara në urdhrin e drejtorit të spitalit.

5. Ministri i Shëndetësisë miraton modelin e udhëzuesit klinik dhe të kartelës së pacientit për shërbimin e urgjencës, të hartuara nga klinikat universitare përkatëse.

6. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM **Nr.448, datë 9.7.2004**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.70, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË **MINISTRAVE “PËR STATUSIN E SPITALEVE UNIVERSITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 2 të nenit 37 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Instituti i Ftiziopneumologjisë, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimit dhe kërkimit, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Instituti i Ftiziopneumologjisë dhe Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik kryejnë edhe shërbimin spitalor skondar për Tiranën, ndërsa shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit kryen edhe shërbimin spitalor sekondar për Durrësin.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Drejtorët e spitaleve universitare dhe shefi i shërbimit kirurgjikal i spitalit të Durrësit, nëse janë mjekë, emërohen nga radhët e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë.”.

3. Paragrafi i dytë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Drejtori i Institutit të Ftiziopneumologjisë, drejtori i Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik dhe shefi i shërbimit kirurgjikal të spitalit të Durrësit emërohen nga Ministri i Shëndetësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.449, datë 9.7.2004

PËR FINANCIMIN E URDHRI TË FARMACISTËVE PËR NJË PERIUDHË
NJËVJEÇARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr.9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e fondit Urdhrit të Farmacistëve, në shumën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për një periudhë njëvjeçare, e cila të përdoret për:

a) shpenzime për shpërblimin e drejtuesve dhe të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar në Urdhrin e Farmacistëve, në masën 4 700 000 lekë;

b) shpenzime operative për të siguruar funksionimin e institucionit, në masën 1 700 000 lekë;

c) shpenzime për investime kapitale për pajisje zyre dhe një automjet, në masën 3 600 000 lekë;

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Financave dhe presidenti i Urdhrit të Farmacistëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.450, datë 9.7.2004

PËR KUOTËN E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN USHTARAK
“SKËNDERBEJ” PËR VITIN AKADEMIK 2004-2005

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota kryesore e pranimi në Universitetin Ushtarak “Skënderbej”, për vitin akademik 2004-2005, të jetë 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) studentë.
2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.451, datë 9.7.2004

PËR KRITERET DHE MASËN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË USHTARAKUT AKTIV TË
FORCAVE TË ARMATOSURA, KUR LIROHET NGJA SHËRBIMI NË KËTO FORCA PËR
ARSYE SHËNDETËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, kur sëmuret në detyrë ose për shkak të detyrës, dhe kur vërtetohet me raport të Komisionit të Lartë Mjekësor të Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, lirohet nga shërbimi në Forcat e Armatosura dhe përfiton trajtim financiar deri në punësimin e tij ose në daljen në pension të plotë pleqërie.
2. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ushtarakët që kanë vjetërsi shërbimi jo më pak se 3 (tre) vjet në këto Forca dhe trajtohen me pagën bazë për gradë, si më poshtë vijon:
 - a) Oficerët trajtohen me pagën bazë për gradë të nëntogerit, me vite shërbimi nën 2 vjet;
 - b) Nënoficerët trajtohen me pagën bazë për gradë të nëntetarit, me vite shërbimi nën 2 vjet;
 - c) Ushtarët profesionistë trajtohen me pagën bazë për gradë të ushtarit profesionist I, me vite shërbimi nën 2 vjet.
3. Ushtaraku e përfiton këtë pagë deri në rastin e punësimit ose të plotësimit të kushteve për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi apo pensioni pleqërie. Pagesa të bëhet pranë reparteve ushtarake, ku ushtaraku ka kryer shërbimin.
4. Ky trajtim financiar ndërpritet nëse ish-ushtaraku refuzon vendin e punës që i ofrohet nga zyrat përkatëse të punës dhe nëse deklarohet i aftë nga ana mjekësore, nga Komisioni Mjekësor i Lartë në Spitalin Universitar Qendror Ushtarak.
5. Ushtaraku ka të drejtën e zgjedhjes ndërmjet këtij trajtimi financiar dhe trajtimit me pagesë kalimtare, sipas nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të ish-Ministrisë së Brendshme", të ndryshuar.

6. Periudha e trajtimit financiar, në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, quhet periudhë siguri. Kontributet për sigurimin shoqëror të këtyre ushtarakëve të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Personat përfitues të këtij trajtimi financiar duhet t'i nënshtrohen një herë në vit rivlerësimit mjekësor nga Komisioni Mjekësor i Lartë në Spitalin Universitar Qendror Ushtarak.

8. Efektet financiare për vitin 2004, që arrijnë shumën 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës në zbatim të këtij vendimi.

10. Pika 2 e vendimit nr.86, datë 12.3.1992 të Këshillit të Ministrave "Për disa të drejta e detyrime të ushtarakëve, të cilat rrjedhin nga ligji "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.452, datë 9.7.2004

**PËR KRITERET E DHËNIES SË KREDISË PËR STREHIM USHTARAKUT TË FORCAVE
TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MASËN E KËSAJ KREDIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kriteret për dhënien e kredisë për strehim nga Ministria e Mbrojtjes ushtarakut të pastrehë apo me sipërfaqe të pamjaftueshme banimi të Forcave të Armatosura janë:

- a) Grada e ushtarakut;
- b) Mundësitë financiare për garantimin e kthimit të kredisë;
- c) Renditja si më poshtë vijon:
 - i) ushtarakët aktivë;
 - ii) ushtarakët në rezervë;
 - iii) ushtarakët në lirim apo pension.

2. Trajtimi me kredi për strehim bëhet nëpërmjet sistemit të kredive me fondet që Ministria e Mbrojtjes siguron nga të ardhurat e veta.

3. Ministria e Mbrojtjes, për livrimin e kredisë, mund të negociojë me bankat për arritjen e marrëveshjeve në kushte lehtësuese.

4. Për përfitimin e kredisë, ushtaraku duhet të paraqesë dokumentet si më poshtë vijon:
Ushtaraku i pastrehë:

- a) Kërkesën personale;
- b) Certifikatën e gjendjes familjare;
- c) Dokumentin identifikues;
- ç) Dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale dhe të personave në ngarkim të tij;
- d) Vërtetimin se nuk ka pasuri të paluajtshme në emër të tij apo të personave në ngarkim të tij.

Ushtarakët që kërkojnë kredi për shtesë të sipërfaqes së banimit:

- a) Kërkesën personale;
- b) Certifikatën e gjendjes familjare;
- c) Dokumentin identifikues;
- d) Dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale;
- e) Aktin e pronësisë së banesës ekzistuese.

5. Kur ushtaraku e ndërton vetë banesën duhet të paraqesë dokumentacionin sipas ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar.

6. Masa e kredisë të jetë si më poshtë vijon:

a) Për ushtarakun e pastrehë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë, me interes 3 për qind dhe afat kthimi deri në 25 vjet;

b) Për ushtarakun që kërkon kredi për shtesë të sipërfaqes së banimit deri në 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, me interes 3 për qind, afat kthimi deri në 15 vjet.

7. Kredia të shlyhet me këst mujor, i cili të mos jetë më i lartë se 30 për qind e të ardhurave mujore familjare.

8. Në strukturat e varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të ngrihen komisionet bazë për dhënien e kredisë që, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim, të shqyrtojnë dhe të përgatisin dokumentacionin e duhur për dhënien e kredisë ushtarakut, i cili i dërgohet për shqyrtim komisionit qendror për dhënien e kredisë.

9. Në Ministrinë e Mbrojtjes të ngrihet komisioni qendror për dhënie kredie, i cili pasi shqyrton dokumentacionin e përgatitur nga komisionet bazë propozon ushtarakët përfitues dhe masën e kredisë.

Komisionet e përcaktuara në pikat 8 e 9 të ngrihen me urdhër të titullarëve të strukturave përkatëse.

11. Lista emërore e ushtarakëve përfitues miratohet nga Ministri i Mbrojtjes.

12. Ushtarakët që janë trajtuar apo do të trajtohen me kredi sipas vendimit nr.102, datë 5.3.1999 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore", nuk përfitojnë kredi sipas këtij vendimi.

13. Vendimi nr.58, datë 23.1.2003 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me strehim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura" shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM
Nr.453, datë 9.7.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË DELVINËS TË MJEDISEVE TË ISH-BRIGADËS SË KËMBËSORISË NË DELVINË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-brigadës së këmbëtorisë në Delvinë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Delvinës, për t'u përdorur si shesh ndërtimi për nevoja strehimi dhe shërbimi të komunitetit, me përparësi strehimin e ushtarakëve aktivë dhe ushtarakëve në lirim të këtij qyteti.

2. Prona me numër rendor 637, "Ish-brigadë këmbësorie", në Delvinë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Delvinës i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Delvinës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.454, datë 9.7.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË LAÇIT TË MJEDISEVE TË ISH-REPARTIT USHTARAK NR.1022 NË LAÇ, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-repartit ushtarak nr.1022 në lagjen Sanxhak, Laç, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Laçit, për t'u

përdorur në shërbim të komunitetit të këtij qyteti për nevoja arsimimi, mjedise spitalore dhe zyra pune.

2. Prona me numër rendor 772, "Ish-reparti ushtarak nr.1022", në lagjen Sanxhak, në Laç, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Laçit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Laçit të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.456, datë 9.7.2004

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË AGJENCISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK, SHA, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR SISTEMIMIN E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasuria me numër 7/55, ndërtesa dykatëshe e Agjencisë për Zhvillim Ekonomik, sh.a., e regjistruar në regjistrin hipotekor nr.286, ZK 8250, datë 2.12.2002, në pronësi të Këshillit të Ministrave, t'i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për sistemimin me mjedise pune të Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

2. Detyrimet e Agjencisë për Zhvillim Ekonomik, sh.a., në likuidim, të shlyhen sipas vendimit nr.416, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe nga privatizimi i shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorë jostrategjikë", i ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Ekonomisë dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM
Nr.458, datë 9.7.2004

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE, NË KOMUNËN MARKAT TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi prej 1 100 000 (një milionë e njëqind mijë) lekësh, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, në komunën Markat të qarkut të Vlorës, që u zhvilluan më 21.3.2004.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.459, datë 9.7.2004

PËR DHËNIE FONDI DISA PARTIVE POLITIKE TË REJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T’u jepet si ndihmë financiare, në çastin e krijimit, fondi prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh secilës nga tri partitë e mëposhtme:

a) Partisë Demokratike Peza Gjirokastër të Shqipërisë;

b) Partisë së të Drejtave të Mohuara të Shqipërisë;

c) Partisë së Integritit Social Kombëtar Shqiptar.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.462, datë 9.7.2004

PËR LEJIMIN E "ANTA" SHA TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR PAGESËN E KONSULENTËVE JURIDIKË TË PËRZGJEDHUR, PËR PËRGATITJEN E ANALIZËS JURIDIKE TË MBULIMIT TË GARANCISË POLITIKE TË RISKUT, TË KREDISË, QË DO TË MERRET NGA BNP PARIBAS BANK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË MODERNIZIMIT TË TRAFIKUT AJROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA) sh.a. që, për fondin limit prej 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) USD, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” me katër konsulentët juridikë: 1. Weil, Gotshal & Manges LLP në Nju-Jork, honorarët e të cilit arrijnë shumën 400 000 USD; 2. Weil, Gotshal & Manges LLP në Bruksel, honorarët e të cilit arrijnë shumën 35 000 USD; 3. Studio Legale Tonucci në Shqipëri, honorarët e të cilit arrijnë shumën 100 000 USD; dhe 4. Thompson Coburn në Washington D.C., konsulent juridik i BNP Paribas, honorarët e të cilit arrijnë shumën 15 000 USD, të përzgjedhur nga US Exim Import Bank, për analizën juridike të mbulimit të garancisë politike të riskut, të kredisë, që do të merret nga BNP Paribas Bank.

2. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e "ANTA" sh.a.

3. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.464, datë 2.7.2004

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË NORMAVE TË TRAJTIMIT ME UNIFORMË TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e normave të trajtimit me uniformë për ushtarakët aktivë (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), ushtarët e shërbimit të detyrueshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, studentët dhe kursantët ushtarakë të shkollave të larta ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, dhe kursantët e Akademisë së Nënoficerëve sipas pasqyrave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Uniforma, me gradat dhe simbolet e tjera që mbahen në uniformë, jepet falas për ushtarakët e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ushtarakët që dalin në pension apo largohen nga ushtria për arsye shëndetësore ose për shkak të ristrukturimit, kur bëhen ndryshime në strukturë e shkurtime në numrin e personelit të Forcave të Armatosura dhe kanë fituar statusin e ushtarakut, përfitojnë kostum ceremonial, të shoqëruar me shenjat, emblemat dhe dekoracionet përkatëse.

4. Kur ushtaraku humbet jetën ose bie në krye të detyrës, familjes i jepet një komplet uniforme ceremoniale: këmbishë, kollare, këpucë dhe të brendshme për oficerët, kostum pune, këmbishë, kollare, këpucë dhe të brendshme për nënoficerët dhe kostum stërvitjeje kamuflazhi, këpucë dhe të brendshme për ushtarët për ceremoninë e varrimit.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.418, datë 10.6.1996 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e normave të veshmbathjes së ushtarakëve të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Pasqyra nr. 1

NORMA E TRAJTIMIT ME UNIFORMË PËR OFICERËT

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/m	Sasia	Afati në vite
1	Pardesy	copë	1	5
2	Xhakavento	copë	1	3
	a) Për oficerët e shtabeve të njërive të lart		1	4
	b) Për oficerët e batalioneve të poshtë			
3	Xhupa me veshje të ngrohtë	copë	1	4
	a) Për oficerët e shtabeve të njërive të lart	copë	1	3
	b) Për oficerët e batalioneve të poshtë			
4	Shall	copë	1	3
5	Pelerinë shiu	copë	1	4
	a) Për oficerët e shtabeve të njërive të lart		1	5
	b) Për oficerët e batalioneve të poshtë			
6	Kostum pune teritali (një kapele, një xhakëtë, dy palë pantallona, një kravatë)	komplet	1	2
	a) Për oficerët e shtabeve të njërive të lart		1	3
	b) Për oficerët e batalioneve të poshtë			
7	Kostum ceremonial (një kapele, një xhakëtë, një palë pantallona, një kravatë)	komplet	1	5
8	Kostum veror për oficerët e FD (një kapelë, një xhakëtë, dy palë pantallona)	kompl		2
9	Kostum civil (një xhakëtë, dy palë pantallona)	komplet	1	5
10	Pantallona terital verore (përfshijë oficerët e FD)	Palë	2	2
	kapele vere teritali në formë zarfi	copë	2	2
11	Këmishë me mëngë të gjata	copë	2	2
12	Këmishë me mëngë të shkurtra	copë	2	2
13	Pulovër	copë	1	3
	a) Për oficerët e shtabeve të njërive të lart		1	4
	b) Për oficerët e batalioneve të poshtë			
14	Këllëf kapele për oficerët e FD	copë	2	1

15	Këpucë gjysma a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lart b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	palë	1 1	8 muaj 1
16	Çorape	palë	4	1
17	Rrip mesi a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lart b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	copë copë	1 1	5 3
18	Rrip pantallonash (për FD dhe rrip të bardhë)	copë	1	3
19	Kostum kamuflazhi (kapele, xhaketë, pantallona) a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lart b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	copë copë	2 2	3 1
20	Këpucë stërvitjeje me qafa a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lart b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	copë copë	1 1	3 1
21	Çantë për dokumente a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lart b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	copë	1 1	3 2
22	Çantë shpine a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lart b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	copë	1 1	8 6
23	Doreza meshini me gëzof	palë	1	5
24	Pagure	copë	1	Pa afat
25	Gavetë	copë	1	Pa afat
26	Lugë gjelle	copë	1	Pa afat
27	Helmetë	copë	1	Pa afat
28	Kostum sportiv	komplet	1	2
29	Këpucë atletike	palë	1	2
30	Dekoratë shirit	copë	1	Pa afat
31	Mushama shiu a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lartë b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	copë	1 1	4
32	Bluzë trikotazhi a) Për oficerët e shtabeve të njësive e lartë b) Për oficerët e batalioneve e poshtë	copë copë	2 2	2 1

Shënim.

1. Për femrat, në vend të një palë pantallona, mund t'u jepet një fund.
2. Ushtarakët që transferohen nga një forcë në tjetrën pajisen me uniformën që mban reparti ku transferohet. Shënimi në kartelën personale bëhet sipas datës që i takon rradha e furnizimit.
3. Ushtarakët e shkollave ushtarake që zhvillojnë stërvitje me efektivin, trajtimi me uniforma është i njëjlojtë me atë të kuadrove komandant batalioni e poshtë.
4. Për kuadrot e armëve speciale (aviacion, FD), trajtimi me uniforma është i njëjlojtë me atë të kuadrove të shtabeve në njësi e lartë.
5. Kuadrove ushtarakë që dërgohen jashtë shtetit për kualifikim apo nevoja të tjera pune, në vend të kostumit të punës, pardesysë, kravatës e këmishave, për llogari të furnizimit të rradhës mund t'u jepet uniformë civile.
6. Sasia e gradave dhe shenjave që mbahen në uniformën ushtarake, si dhe afati i përdorimit të tyre do të jetë sipas llojit të uniformës e afatit të përdorimit të saj.
7. Oficerët që emërohen për herë të parë, furnizohen me veshmbathje komplete sipas normës.

8. Për oficerët e Policisë Ushtarake, në normën e artikujve xhup me veshje të ngrohtë e kostum kamuflazhi t'i jepet xhup e kostum operacional shërbimi. Mbi normë jepen një palë doreza operationale me afat përdorimi 5 vjet dhe dy bluza trikotazhi tip golf me afat përdorimi 3 vjet.

9. Për oficerët e shtabit të Policisë Ushtarake, normat e trajtimit me veshmbathje janë si ato të oficerëve të shtabeve në njësi e lart.

10. Për oficerët e qarkullimit rrugor të Policisë Ushtarake, që përfitojnë veshje material inventar reparti (xhakëtë lëkure, pantallona lëkure) etj., afatet e përdorimit të xhupave zgjaten dhe dy vjet.

Pasqyra nr. 2

NORMA E TRAJTIMIT ME UNIFORMË PËR NËNOFICERËT

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/m	Sasia	Afati në vite
1	Pardesy	copë	1	5
2	Shall	copë	1	3
3	Xhakavento			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	4
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	3
4	Xhupa me veshje të ngrohtë			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	3
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	4
5	Pelerinë shiu			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	5
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	4
6	Kostum pune teritali (një kapele, një xhakëtë, dy palë pantallona, një kravatë)	komplet	1	3
	a) Për nënoficerët e karrierës		1	2
	b) Për nënoficerët e tjerë			
7	Kostum veror për nënoficerët e FD (një kapele, një xhakëtë, dy palë pantallona)	komplet	1	2
8	Kostum civil (një xhakëtë, dy palë pantallona)	komplet	1	5
9	Pantallona teritali verore (përfshirë nënoficerët e FD) kapele vere teritali në formë zarfi	Palë	2	2
		copë	2	2
10	Këmishë me mëngë të gjata	copë	2	2
11	Këmishë me mëngë të shkurtra	copë	2	2
12	Pulovër			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	4
	b) Për nënoficerët e tjerë			3
13	Këllëf kapele për nënoficerët e FD	copë	2	1
14	Këpucë gjysma			
	a) Për nënoficerët e karrierës	palë	1	1
	b) Për nënoficerët e tjerë		1	8 muaj
15	Çorape	palë	4	1
16	Rrip mesi			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	3
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	5
17	Rrip pantallonash (për FD dhe rrip të bardhë)	copë	1	3
18	Kostum kamuflazhi (kapele, xhakëtë, pantallona)			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	2	1
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	2	3
19	Këpucë stërvitjeje me qafa			

	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	1
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	3
20	Çantë për dokumente			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	2
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	3
21	Çantë shpine			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	6
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	8
22	Doreza meshini me gëzof	palë	1	5
23	Pagure	copë	1	Pa afat
24	Gavetë	copë	1	Pa afat
25	Lugë gjelle	copë	1	Pa afat
26	Helmetë	copë	1	Pa afat
27	Kostum sportiv	komplet	1	2
28	Këpucë atletike	palë	1	2
29	Shirit gradë	copë	1	Pa afat
30	Mushama shiu			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	1	4
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	1	5
31	Bluzë trikotazhi			
	a) Për nënoficerët e karrierës	copë	2	1
	b) Për nënoficerët e tjerë	copë	2	2

Shënim.

1. Për femrat, në vend të një palëve pantallona mund t'u jepet një fund.
2. Nënoficerëve që dërgohen jashtë shtetit për kualifikim apo nevoja të tjera pune, në vend të kostumit të punës, pardesysë, kravatës e këmishave, për llogari të furnizimit të rradhës mund t'u jepet uniformë civile.
3. Sasia e gradave dhe shenjave që mbahen në uniformën ushtarake, si dhe afati i përdorimit të tyre do të jetë sipas llojit të uniformës e afatit të përdorimit të saj.
4. Nënoficerët që merren në punë për herë të parë, fillimisht furnizohen vetëm me kostum, këpucë stërvitjeje e rrip mesi. Pjesët e tjera të uniformës t'i jepen pasi janë marrë në provë e është miratuar për të qëndruar në punë. Nënoficerët që largohen vetë nga puna, të zhdëmtojnë vlefën e mbetur të veshmbathjes që është furnizuar.
5. Për nënoficerët e orkestrës frymore të ushtrisë, kostumi i punës terital (një kapele, një xhaketë, dy palë pantallona) është një komplet në 3 vjet.
6. Për nënoficerët e qarkullimit rrugor të Policisë Ushtarake që përfitojnë veshje material inventar reparti (xhaketë lëkure, pantallona lëkure) etj., afatet e përdorimit të xhupave zgjaten dhe 2 vjet.
7. Për nënoficerët e Policisë Ushtarake, në normën e artikujve xhup me veshje të ngrohtë e kostum kamuflazhi t'u jepet xhup e kostum operacional shërbimi. Mbi normë jepen një palë doreza operacionale me afat përdorimi 5 vjet dhe dy bluza trikotazhi tip golf me afat përdorimi 3 vjet.
8. Në kategorinë "nënoficerë të tjerë", përfshihen nënoficerët që punojnë në sektorin e administrimit, furnizimit dhe mirëmbajtjes.

Pasqyra nr.3
NORMA E TRAJTIMIT ME UNIFORMË PËR STUDENTËT
E UNIVERSITETIT USHTARAK

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/m	Sasia	Afati në vite
1	Pardesy	copë	1	4
2	Xhup me veshje të ngrohtë	copë	1	2
3	Pelerinë shiu	copë	1	4
4	Kostum pune teritali (një kapele, një xhakëtë, dy palë pantallona,)	komplet	1	2
5	Pantallona teritali vere (përjashtuar studentët e Akademisë së Detarisë) kapele në formë zarf	Palë	2 2	2 2
6	Këmishë me mëngë të gjata	copë	2	1
7	Këmishë me mëngë të shkurtra	copë	2	2
8	Gravatë	copë	1	4
9	Këpucë gjysma	palë	1	88 muaj
10	Kostum veror vetëm për studentët e Akademisë së Detarisë (një kapelë, një xhakëtë, dy palë pantallona, dy këllëf kapele)	komplet	1	4
11	Këllëf kapele për oficerët e FD	copë	2	1
12	Rrip mesi	copë	1	4
13	Rrip pantallonash	copë	2	4
14	Kostum kamuflazhi	komplet	2	2
15	Këpucë stërvitjeje me qafa	palë	1	2
16	Çorape	palë	4	1
17	Pulovër	copë	1	4
18	Këmishë e mbathje dimri (fanellatë)	komplet	2	2
19	Këmishë e mbathje vere	komplet	2	2
20	Kanotjerë pambuku	copë	2	1
21	Çantë shpine	copë	1	4
22	Pagure	copë	1	8
23	Gavetë	copë	1	8
24	Lugë gjelle	copë	1	4
25	Helmetë	copë	1	Pa afat
26	Kostum sportiv	komplet	1	2
27	Këpucë atletike	palë	1	2
28	Shami dore	copë	2	1
29	Peshqirë me push	copë	2	2
30	Peshqirë banje	copë	2	4
31	Doreza meshini	palë	1	4
32	Fanellë trikotazhi me vija e jaka me vija (vetëm për studentët e Akademisë së Detarisë)	copë	2	2
33	Kostum banje	palë	1	2
34	Fletë çadre	copë	1	9
35	Mushama shiu	copë	1	4
36	Çantë për dokumente	copë	1	4

Shënim.

1. Materialet e veshmbathjes, që në momentin e dhënies bëhen pronë vetjake e tyre dhe shkarkohen nga librat e llogarisë, pas plotësimit të afatit të përdorimit.

2. Studentët në fushime dimërore në vende malore, furnizohen me nga një kokore leshe me afat përdorimi 10 vjet.

3. Studentëve të Akademisë së Detarisë u jepen një palë kominoshe pune me afat përdorimi 4 vjet.

4. Universitetit të Mbrojtjes i lejohet të mbajnë gjendje si material inventar doreza të bardha për truporje nderi për t'i përdorur në rast ceremonish. Afati i përdorimit të tyre është një palë në 5 vjet.

5. Sasia e spalinave, shenjave dalluese, emblemave e shiritave, si dhe afati i përdorimit të tyre do të jetë sipas llojit të uniformës e afatit të përdorimit të saj.

Pasqyra nr. 4

NORMA E TRAJTIMIT ME UNIFORMË PËR USHTARËT

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/m	Sasia	Afati në vite
1	Xhup me veshje të ngrohtë	copë	1	1
2	Mushama shiu	copë	1	2
3	Kostum kamuflazhi	komplet	2	1
4	Këmishë e mbathje vere	copë	2	1
5	Këmishë e mbathje dimri fanellatë	copë	2	2
6	Bluzë trikotazhi	komplet	2	2
7	Çorape	palë		1
8	Këpucë stërvitjeje me qafa	palë	2	1
9	Këpucë atletike	palë	1	2
10	Çizme gome	palë	1	2
11	Kostum sportiv (bluzë, tuta)	komplet	1	
12	Rrip mesi	copë	1	2
13	Rrip pantallonash	copë	1	2
14	Shami dore	copë	4	1
15	Peshqirë me push	copë	2	1
16	Çantë shpine	copë	1	4
17	Doreza leshe	palë	1	2
18	Kokore leshe	copë	1	4
19	Lugë gjelle	copë	1	1
20	Gavetë	copë	1	6
21	Pagur uji	copë	1	6
22	Helmetë metalike	copë	1	Pa afat
23	Pantofla	palë	1	1
24	Emblema	copë	2	1
25	Fletë çadra	copë	1	10
26	Shenjë flamuri	copë	2	1
27	Shenjë force	copë	2	1

Shënim.

1. Materialet e veshmbathjes, afati i përdorimit të të cilave përputhet me kohën e shërbimit ushtarak të efektivit, trajtohen si materiale pronë vetjake dhe shkarkohen nga librat e llogarisë materiale pas plotësimit të afateve të përdorimit. Administrimi i këtyre materialeve, gjatë kohës së shërbimit ushtarak, bëhet edhe me kartelë personale.

2. Për ushtarët aktivë e profesionistë të Policisë Ushtarake, në vend të xhupit me veshje të ngrohtë e kostumit të kamuflazhit t'u jepet xhup e kostum operacional e shërbimi. Mbi normë jepen një palë doreza operacionale me afat përdorimi 5 vjet dhe dy bluza trikotazhi tip golf me afat përdorimi 3 vjet.

3. Me këtë normë furnizohen edhe efektivat me mision jashtë shtetit. Kur efektiv i dërgohet me shërbim jashtë shtetit ose zhvillon stërvitje të përbashkëta me forca të ushtrive të tjera në vendin tonë, mbi normën bazë u jepet dhe veshje të tjera suplementare kuotë pastrimi (pasqyra nr.4/1). Veshja suplementare dhe kuota e mirëmbajtjes të mbahet në gadishmëri si material inventar reparti. Norma e veshmbathjes suplementare përlllogarit si kohë përdorimi e jo si vit kalendarik.

4. Ushtarëve të forcave speciale, gjatë fushimeve jashtë qendrave të stërvitjes, u jepen mbi normë, dyshek alpin me afat përdorimi 1 në 5 vjet. Kur fushimi kryhet në kushte dimërore në zona shumë të ftohta u jepet edhe kokore leshi me afat përdorimi 1 në 4 vjet.

5. Reparteve u lejohet të mbajnë gjendje si material inventar reparti doreza të bardha për truprojet e nderit, për t'u përdorur në raste ceremonish, me afat përdorimi 1 palë në 5 vjet.

6. Me këtë normë furnizohen edhe ushtarët rrogëtarë me këtë ndryshim:

- Afati i përdorimit për xhupin me veshje të ngrohtë është 2 vjet, rripin e mesit 3 vjet, rripin e pantallonave 3 vjet, pantofla 2 vjet, lugë gjelle 2 vjet.

- Ushtarëve profesionistë që merren në shërbim për herë të parë, fillimisht furnizohen vetëm me një kostum stërvitjeje, këpucë stërvitjeje dhe rrip mesi e pantallonash. Pjesët e tjera të uniformës iu jepen pasi të jenë marrë në provë. Ushtarët profesionistë që largohen vetë nga puna të zhdëmtojnë vleftën e mbetur të veshmbathjes që është furnizuar.

- Pikat e tjera të shënimeve për ushtarët aktivë janë të barazvleshme edhe për ushtarët profesionistë.

Pasqyra 4/1

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/m	Sasia	Afati në vite
1	Kostum stërvitjeje	komplet	1	6 muaj
2	Këpucë stërvitjeje	palë	1	1
3	Kanotjere	copë	2	3 muaj
4	Mbathje vere	palë	2	3 muaj
5	Çorape	palë	2	3 muaj
6	Kostum sportiv	komplet	1	1
7	Këpucë atletike	palë	1	1
8	Çantë shpinë e madhe	copë	1	4
9	Konupjere	copë	1	3
10	Dyshek alpin	copë	1	4
11	Kostum i gomuar	komplet	1	4
12	Sapun kallëp	gram	250	1 muaj
13	Sapun tualeti	gram	200	1 muaj
14	Detergjent	gram	100	1 muaj
15	Bojë këpucësh	gram	100	1 muaj

Pasqyra nr. 5

NORMA E TRAJTIMIT ME UNIFORMË PËR DETARËT

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/m	Sasia	Afati në vite
1	Xhaketon leshi	copë	1	1
2	Kostum doku pune (jakë me vija, bluzë, pantallona)	komplet	2	1
3	Beretë pune prej stofi teritali	copë	2	1
4	Kostum terital për dalje të lirë (kapele me këllëf, jakë me vija, bluzë e pantallona të gjata)	komplet	1	1
5	Bluzë doku për dalje të lirë	copë	1	1
6	Fanellë trikotazhi me vija	copë	2	1
7	Mbathje vere	copë	2	1
8	Kanotjere pambuku	copë	2	1
9	Çorape	komplet	6	1
10	Mbathje dimri (fanellatë ose trikotazhe)	palë	2	1
11	Kominoshe pune për detarët e anijeve mbiujëse	palë	1	2
12	Këpucë atletike	palë	1	1
13	Këpucë me qafa të shkurtra	palë	2	1
14	Rrip mesi	copë	1	2
15	Rrip pantallonash	copë	1	2
16	Peshqirë me push	copë	2	1
17	Çantë shpine	copë	1	4
18	Shami dore	copë	4	1
19	Lugë gjelle	copë	1	1
20	Doreza leshi	palë	1	1
21	Pantofla	palë	1	1
22	Emblema	copë	2	1
23	Pelerinë shiu (vetëm për rojet)	copë	1	3
24	Fjongo	copë	1	1

Shënim.

1. Materialet e veshmbathjes, afati i përdorimit të të cilave përputhet me kohën e shërbimit ushtarak të efektivit, trajtohen si materiale pronë vetjake dhe shkarkohen nga librat e llogarisë materiale pas plotësimit të afateve të përdorimit. Administrimi i këtyre materialeve, gjatë kohës së shërbimit ushtarak bëhet edhe me kartelë personale.

2. Detarëve në vend të një kostumi doku pune mund t'u jepet një kostum leshi me afat përdorimi 1 vit.

Pasqyra Nr.6
NORMA E TRAJTIMIT ME UNIFORMË PËR USHTARAKËT
DHE USHTARËT REZERVISTË

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/m	Sasia	Afati në vite
1	Xhup me veshje të ngrohtë	copë	1	15
2	Fletë çadra	copë	1	15
3	Kostum kamuflazhi	komplet	1	10
4	Këpucë stërvitjeje me qafa	palë	1	10
5	Peshqirë trupi	copë	1	10
6	Çantë shpine	copë	1	15
7	Rrip mesi	copë	1	15
8	Rrip pantallonash	copë	1	15
9	Pagur uji	copë	1	Pa afat
10	Gavetë alumini	copë	1	Pa afat
11	Helmetë metalike	copë	1	Pa afat
12	Të brendshme	palë	1	15
13	Çorape	palë	1	6

VENDIM
Nr.52, datë 14.7. 2004

PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

Baza ligjore
Neni 1

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 12 germa "a", të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 26 pika 3 germa "b"; neni 28; neni 31 pika 2; neni 36 dhe neni 37.

Qëllimi
Neni 2

Qëllimi i kësaj rregulloreje është administrimi i rrezikut të kredisë në mënyrë që banka të minimizojë humbjet e mundshme nga kreditë dhe nga aktivet e tjera të ngjashme me to dhe të ndjeshme ndaj lëvizjeve të normave të interesit (më poshtë, aktive të tjera).

Në këtë rregullore përcaktohen kriteret, kategoritë dhe metodat e klasifikimit të kredive dhe të aktiveve të tjera të bankës, duke llogaritur një nivel të përshtatshëm fondesh rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga pamundësia e rekuperimit të vlerës së plotë të tyre.

Për nevojat e kësaj rregulloreje, me rrezik të kredisë kuptohet pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit të kredisë ose e kundërpartisë për aktivet e tjera, për të përmbushur detyrimet ndaj bankës sipas kushteve të marrëveshjes të lidhur mes tyre.

Subjektet
Neni 3

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet e tjera jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për dhënien e kredive. Në vijim të kësaj rregulloreje, këto subjekte do të njihen me termin "bankë".

Klasifikimi i kredive

Neni 4

4.1 Bankat klasifikojnë kreditë e tyre në një nga pesë kategoritë e mëposhtme:

1. kredi standarde,
2. kredi në ndjekje,
3. kredi nënstandarde,
4. kredi të dyshimta,
5. kredi të humbura.

Kategoria 1 përfaqëson cilësinë më të lartë të kredisë, ndërsa kategoria 5 përfaqëson cilësinë më të ulët të kredisë.

4.2 Kreditë e klasifikuara në kategoritë 1 dhe 2 përbëjnë grupin e kredive cilësore. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive cilësore.

4.3 Kreditë e klasifikuara në kategoritë 3, 4, 5 përbëjnë grupin e kredive me probleme. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive me probleme.

Karakteristikat për klasifikimin e kredive

Neni 5

5.1 Për klasifikimin e kredive sipas kategorive të mësipërme, banka analizon sipas përparësisë dhe në mënyrë plotësuese, karakteristikat e mëposhtme :

a) gjendjen financiare të kredimarrësit, analiza e së cilës konsiderohet parësore në klasifikimin e kredive;

b) gjendjen financiare të garantuesit të kredisë, kur banka nuk krijon bindje ose ka vështirësi për klasifikimin e kredisë, duke u mbështetur vetëm në karakteristikën “a”;

c) sigurimin e kredisë të mbështetur në analizën dhe në vlerësimin e cilësisë së kolateralit dhe/ose të garancisë, kur kolaterali dhe/ose garancia ekzistojnë. Analiza e sigurimit të kredisë, duke qenë në vazhdimësi një element i nevojshëm, bëhet e domosdoshme kur banka nuk krijon bindje ose ka vështirësi për klasifikimin e kredisë duke u mbështetur vetëm në karakteristikën “a”;

d) ditëvonesat në shlyerjen e kredisë, si të kryegjësë, ashtu edhe të interesit, të cilat konsiderohen një arsye për bankat për të bërë riklasifikimin e kredive;

e) lëvizjet në llogari për kreditë kufi, me përjashtim të riklasifikimit, të regjistrimit të interesave të llogaritur apo të kapitalizimit të tyre, si edhe të kthimit të kredisë me qëllim përfitimin e menjëhershëm të një kredie me vlerë më të madhe, në kushtet, kur nuk ka pasur lëvizje në llogari për shlyerje të mëparshme . Kjo analizë fiton rëndësi më të madhe, kur banka nuk krijon bindje ose ka vështirësi për klasifikimin e kredisë, duke u mbështetur vetëm në karakteristikat e mësipërme;

f) ristrukturimi i kredisë si rezultat i paaftësisë për ta shlyer atë nga kredimarrësi dhe/ose garantuesi. Kjo karakteristikë konsiderohet e pavarur nga të tjerat, për klasifikimin e kredive si kredi me probleme;

g) karakteristika të tjera të parashikuara në dokumentet e bankës, të cilat pranohen vetëm kur kredia klasifikohet në një kategori me cilësi më të ulët se ajo e parashikuar nga analiza e karakteristikave të mësipërme.

5.2 Inspektorët e mbikëqyrjes kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit të kredive në rastet kur:

- gjykojnë se interpretimi i kriterëve të mësipërme nga bankat nuk është i drejtë;
- gjykojnë se ka elemente të tjera shtesë, përveç karakteristikave të mësipërme, që e justifikojnë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit.

Kërkesa të përgjithshme

Neni 6

Bankat, miratojnë në këshillin drejtues, dokumentet e politikave, të procedurave dhe të rregullave të brendshme për monitorimin dhe për kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredive dhe të aktiveve të tjera të bankës. Këto dokumente duhet të përmbajnë minimalisht:

- a) strategjinë e kreditimit;
- b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë së kredive;
- c) rregullat e vendosura për njohjen dhe analizën e kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;
- d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë;
- e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë për një klient, përqendrimin e kredisë sipas sektorëve dhe raportin e rrezikut të kredisë me rreziqet e tjera (ndryshimi i kursit të këmbimit, ndryshimi i normës së interesit etj.);
- f) procedurat për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredive, për ndjekjen me përparësi të kredive me probleme, për rivlerësimin e vazhdueshëm të garancive apo të kolateraleve dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë;
- g) procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera, për angazhimet e dhëna për financimet, për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, si dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së tyre;
- h) procedurat e miratimit dhe të administrimit për kreditë kufi (sipas kuptimit në pikën 2.3.3 “kredi me llogari të zbuluar” të Manualit të Kontabilitetit Bankar, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.820, datë 30.12.1998).

Rregulla të përgjithshme të bankës

Neni 7

Manualet dhe/ose politikat e bankës, duhet të kërkojnë të vlerësohet në vazhdimësi jo vetëm cilësia e portofolit të kredive dhe e aktiveve të tjera, por edhe rreziku i humbjes si rezultat i zhvlerësimit të tyre. Për këtë, në këto dokumente përcaktohen minimalisht:

7.1 Mënyra e organizimit të procesit të ndjekjes së kredisë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar nga elementet e mëposhtme:

- a) njësitë administrative që merren me vlerësimin e rrezikut, me përllogaritjen e provigjoneve dhe ekzekutimin e tyre;
- b) metodat e vlerësimit të aftësisë shlyerëse të kredimarrësit (duke përfshirë rreziqet që mund të paraqesë kreditimi në rastet kur njësia monetare e dhënies së kredisë është e ndryshme nga njësia monetare në të cilën janë të ardhurat e kredimarrësit etj.), të garancive dhe të kolateraleve përkatëse;
- c) bashkëveprimin me njësitë e pavarura të kontrollit të brendshëm dhe/ose të jashtëm;
- d) periodicitetin e vlerësimit, të klasifikimit dhe të parashikimit për fonde rezervë për mbulimin e rrezikut;
- e) periodicitetin e raportimit për administratorët e bankës.

7.2 Mënyra e kryerjes së analizës së gjendjes financiare të kredimarrësit dhe të besueshmërisë së tij (si element parësor në klasifikimin e kredisë), duke përfshirë, por duke mos u kufizuar nga elementet e mëposhtme:

- a) madhësia dhe burimi i të ardhurave të kredimarrësit për shlyerjen e kredisë;
- b) kreditë e tjera dhe rregullshmëria e shlyerjes së tyre;
- c) kreditë ndaj personave të lidhur dhe rregullshmëria e shlyerjes së tyre;
- d) bilanci kontabël dhe llogaria e rezultatit financiar (Humbje e fitime);
- e) biznesplanin dhe pasqyra e fluksit të rrjedhjes së parave dhe parashikimit për të ardhmen;
- f) historia e shlyerjes së kredive në të kaluarën dhe në vazhdimësi;

g) kapaciteti shlyerës i kredisë për personat fizikë dhe juridikë nga analiza e ciklit të biznesit të kredimarrësit.

7.3 Mënyra e kryerjes së analizës së gjendjes financiare të garantuesit të kredisë dhe të besueshmërisë së tij.

Kjo analizë bëhet me qëllim që të vlerësohet aftësia ripaguese e garantuesit dhe të mbështetet mbi të njëjtat dokumente, mbi bazën e të cilave bëhet analiza e gjendjes financiare të kredimarrësit.

7.4 Mënyra e kryerjes së analizës së sigurimit të kredisë, e cila ka për qëllim të vlerësojë nëse një kredi është apo nuk është e siguruar mirë.

Me kredi të siguruar mirë kuptojmë që kolaterali ose garancia e përdorur për të siguruar këtë kredi, është e mjaftueshme që të mbrojë bankën nga humbja e kryegjësë dhe e interesit.

Me mjaftueshmëri në këtë rast, kuptojmë ekzistencën e një dokumentacioni ligjor, që siguron bankën se me ekzekutimin e kolateralit dhe/ose të garancisë, do të mbulojë sasinë e kryegjësë dhe të interesit, si dhe koston e mbledhjes ose të ekzekutimit të kolateralit dhe/ose të garancisë.

Kreditë standarde

Neni 8

Bankat klasifikojnë si “kredi standarde” të gjitha kreditë, përveç atyre të klasifikuara sipas neneve 9,10,11 dhe 12.

Kur kësti i kredive standarde, që shlyhen me këste, nuk është paguar në afat për një periudhë prej 1 deri në 30 ditë, atëherë vetëm kësti i papaguar klasifikohet në rubrikën 2.1 të Manualit të Kontabilitetit Bankar (“kredi dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin”) dhe kjo shumë përfshihet gjithashtu, në kredinë standarde.

Kreditë në ndjekje

Neni 9

Bankat klasifikojnë si “kredi në ndjekje”, kreditë, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet e mirë, por me dobësi të mundshme të gjendjes financiare të kredimarrësit në një kohë të ardhme;
2. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet e mirë;
3. Kredia vlerësohet si “e siguruar mirë”, sipas përcaktimeve në nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;
4. Kryegjësja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 deri 30 ditësh nga afati i maturimit në rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;
5. Kryegjësja ose interesi, nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit në rastet kur kredia shlyhet me këste;
6. Kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 31 deri 60 ditë për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi.

Kreditë nënstandarde

Neni 10

Bankat klasifikojnë si “kredi nënstandarde”, kreditë, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet jo e kënaqshme, pasi të ardhurat e tij nga aktiviteti kryesor gjykohen të pamjaftueshme;
2. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet e mirë, por parashikohen probleme në të ardhmen;
3. Kredia vlerësohet se nuk është e siguruar mirë, vlera e kolateralit dhe/ose e garancisë vlerësohet se nuk është në përputhje me nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;

4. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;

5. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia shlyhet me këste;

6. Kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 61 deri 180 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredinë kufi;

7. Kredia është ristrukturuar një herë nga paaftësia për ta paguar atë dhe plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

a) kredia nuk po shlyhet për vlerën e kryegjësë dhe të interesit, sipas kushteve të reja;

b) pavarësisht nga ecuria e kredisë me kushtet e reja, nuk kanë kaluar më tepër se 365 ditë nga dita e ristrukturimit.

Kreditë e dyshimta

Neni 11

Bankat klasifikojnë si “kredi të dyshimta”, kreditë, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit nuk vlerësohet e mjaftueshme për të paguar në total detyrimin e tij mbi kredinë ose detyrime të tjera të tij ndaj bankës ose ndaj personave të tretë;

2. Deklarimi i kredimarrësit si “i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale;

3. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë nuk vlerësohet e mjaftueshme për të përmbushur angazhimet e dhëna ndaj kredimarrësit dhe ndaj bankës, të paktën përkohësisht;

4. Kredia vlerësohet se nuk është e siguar mirë, sipas përcaktimit në nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;

5. Kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;

6. Kur kryegjëja ose interesi, nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej 181 deri 365 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia shlyhet me këste;

7. Kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për 181 deri 365 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredinë kufi;

8. Kredia është ristrukturuar dy herë për shkak të paaftësisë për ta paguar atë dhe plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

a) që prej ristrukturimit të fundit, kredia nuk po shlyhet për vlerën e kryegjësë dhe të interesit, sipas kushteve të reja;

b) pavarësisht nga ecuria e kredisë me kushtet e reja, nuk kanë kaluar më tepër se 550 ditë nga dita e ristrukturimit të fundit.

9. Banka ka vepruar juridikisht (ka bërë kërkesë pranë gjykatës së rrethit), për të filluar procesin e ekzekutimit të kolateralit nga ana e zyrës së përmbarimit.

Kreditë e humbura

Neni 12

Bankat klasifikojnë si kredi të humbura ato kredi, të cilat paraqiten me të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

1. Gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë si e paaftë për përmbushjen e kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit;

2. Kredimarrësi ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi dhe ekziston rreziku që disa kreditorë të mbeten të pakënaqur;

3. Kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë;

4. Banka ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (ka dalë vendimi i gjykatës dhe është kryer pagesa për shërbimin e ekzekutimit të kolateralit), për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit nga ana e zyrës së përmbarimit;

5. Të njëjtat pasuri të kredimarrësit janë lënë peng ose janë hipotekuar edhe për kreditorë të tjerë dhe banka nuk mund t'i ekzekutojë në kohën dhe mënyrën e nevojshme, për të recuperuar vlerën e kredisë;

6. Gjendja financiare e garantuesit të kredisë vlerësohet se nuk mund të përmbushë angazhimet e dhëna ndaj kredimarrësit dhe ndaj bankës në vazhdimësi;

7. Kredia vlerësohet se nuk është e siguruar mirë, sipas përcaktimit në nenin 7 pika 7.4 të kësaj rregulloreje;

8. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 181 ditësh nga afati i maturimit, për rastet kur kredia nuk shlyhet me këste;

9. Kur kryegjëja ose interesi nuk janë paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 ditësh nga afati i maturimit për rastet kur kredia shlyhet me këste;

10. Kur kredimarrësi nuk ka lëvizje në llogari për më shumë se 365 ditë, për rastet kur kemi të bëjmë me kredi kufi;

11. Kredia është ristrukturuar për më shumë se dy herë, për shkak të paaftësisë paguese.

Kontabiliteti i interesave

Neni 13

Për kreditë e klasifikuara sipas nenit 10, të cilat janë të pashlyera për më shumë se 90 ditë, si edhe për kreditë e klasifikuara sipas nenit 11 dhe sipas nenit 12, interesat e llogaritura nuk kontabilizohen.

Në rastet kur kredimarrësi shlyen detyrimin, në detyrim përfshihet edhe llogaritja e interesave të pakontabilizuara. Kjo bëhet për të mos rënduar bilancin e bankës për ato vlera të interesit, që janë të pasigurta për t'u arkëtuar.

Arkëtimet pasuese që merr banka, duhet të përdoren më parë për shlyerjen e interesit të të gjithë periudhës dhe më pas të kryegjësë.

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

Neni 14

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, bankat krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë janë:

A. Norma fikse për grupin e kredive cilësore:

1. për “kreditë standarde” dhe “kredi dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin”1 për qind;

2. për “kreditë në ndjekje”5 për qind.

Fondet rezervë për kreditë e mësipërme llogariten mbi vlerën e përbashkët të kryegjësë dhe të interesit dhe konsiderohen fonde rezervë për mbulimin e rrezikut statistikor.

B. Norma të ndryshueshme për grupin e kredive me probleme:

- për kryegjënë:

3. “kredia nëstandarde” jo më e vogël se 20 për qind;

4. “kredia e dyshimtë” jo më e vogël se 50 për qind;

5. “kredia e humbur” jo më e vogël se 100 për qind.

- për interesin e përlllogaritur norma është 100 për qind në çdo rast.

Fondet rezervë të llogaritura për kreditë me probleme konsiderohen fonde rezervë për mbulimin e rrezikut të zhvlerësimit të kredive.

2. Nëse për një kredi plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

a) për sigurimin e të gjithë kredisë (ose të një pjese të saj) është përdorur si kolateral dhe/ose si garanci një depozitë/llogari bankare në *cash*, për të cilën

b) banka ka në mënyrë të dokumentuar të gjitha të drejtat ligjore dhe mundësitë fizike për zotërimin dhe për përfitimin e kolateralit/garancisë në favor të bankës në kohën dhe në mënyrën e nevojshme, nëse kredimarrësi nuk respekton kushtet e kthimit të kredisë, atëherë banka, duke

analizuar të gjitha llojet e rreziqeve, mund ta klasifikojë kredinë (ose pjesën e saj të kolateralizuar me *cash*) në kategorinë në të cilën ajo është e sigurtë që vlera e kolateralit dhe/ose e garancisë së kredisë (ose e pjesës së saj të kolateralizuar me *cash*), së bashku me vlerën e fondeve rezervë të krijuara sipas kuptimit të këtij neni, por jo domosdoshmërisht sipas kërkesave të tij, mbulojnë në mënyrë të mjaftueshme vlerën e kryegjësë dhe të interesit të kredisë (ose të pjesës së saj të kolateralizuar me *cash*).

Kontabiliteti i klasifikimit të kredive dhe fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

Neni 15

Në të njëjtën kategori me kredinë (kryegjënë dhe interesin) që klasifikohet, klasifikohen edhe llogaritë e tjera që lidhen me të, të cilat përfaqësojnë kredi të dhëna nga banka për persona të lidhur dhe të varur financiarisht nga kredimarrësi dhe/ose garanci të dhëna nga banka për të njëjtin kredimarrës ose për persona të lidhur dhe të varur financiarisht prej tij.

Fondet rezervë të llogaritura sipas nenit të mësipërm regjistrohen si shpenzim.

Nëse një kredi riklasifikohet nga njëra kategori tek tjetra:

1. Teprica e kredisë gjithsej (kryegjë dhe interes), si edhe llogaritë e tjera të lidhura me të, të cilat përfaqësojnë kredi të dhëna nga banka për persona të lidhur dhe të varur financiarisht nga kredimarrësi dhe/ose garanci të dhëna nga banka për të njëjtin kredimarrës ose për persona të lidhur dhe të varur financiarisht prej tij, klasifikohen në të njëjtën kategori.

2. Fondet rezervë të llogaritura regjistrohen si “të ardhura” nga rimarrja e fondeve rezervë dhe fondet rezervë të krijuara, sipas klasifikimit të kredisë në kategorinë e re, regjistrohen si “shpenzime”.

Për vlerësimin e kredive, në përputhje me këtë rregullore, bankat dhe degët e bankave të huaja plotësojnë, për çdo kredi, formularin nr.1 bashkëlidhur, i cili ruhet në dosjen e kredimarrësit.

Kapitalizimi i interesit

Neni 16

Kapitalizimi i interesit është procesi në të cilin “interesi i llogaritur” bashkohet me kryegjënë, duke u regjistruar në llogarinë e kryegjësë.

Kapitalizimi i interesit nga bankat, ndodh vetëm nëse plotësohen në të njëjtën kohë kushtet e mëposhtme:

1. Kredimarrësi është në gjendje të paguajë detyrimet e tij nga të ardhurat e veprimtarisë;
2. Kapitalizimi i interesit është parashikuar në kushtet dhe afatet e marrëveshjes fillestare të kredisë, në rast vështirësie likuiditeti të kredimarrësit;
3. Kredia, përfshirë dhe interesin e kapitalizuar, është garantuar mirë;
4. Planbiznesi i kredimarrësit krijon besim që në të ardhmen gjendja financiare do të përmirësohet ndjeshëm ose të ardhurat e tij të veprimtarisë do të rriten në mënyrë të konsiderueshme;
5. Nuk ka rrezik të menjëhershëm për humbje të kredisë, përfshirë dhe interesin e kapitalizuar;
6. Kredimarrësi mund të sigurojë fonde për shlyerjen e kredisë nga burime të tjera në shumën dhe kohën e njëjtë me maturimin e kredisë.

Ristrukturimi i kredisë

Neni 17

Bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, ristrukturojnë kredinë në rastin kur kredimarrësi nuk shlyen kredinë në përputhje me afatet dhe me kushtet e marrëveshjes fillestare, sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë të miratuar nga këshilli drejtues i bankës. Në rast të ristrukturimit të kredisë, në dosje shtohet edhe marrëveshja e ristrukturimit e lidhur ndërmjet bankës dhe kredimarrësit.

Fshirja e kredive të humbura

Neni 18

1. Fshirja e kredive të humbura bëhet me vendim të këshillit drejtues të bankës kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Banka ka përfunduar procesin ligjor të kërimit të kthimit të kredisë nga kredimarrësi dhe kredimarrësi është debitor i bankës për pjesën e pashlyer;

b) Me vendim të këshillit drejtues, kredia është përfshirë në listën e kredive të humbura që mund të fshihen dhe ka përfunduar afati i qëndrimit në këtë listë;

c) Kur kredia është e klasifikuar si “e humbur” dhe nuk është shlyer për më tepër se 365 ditë pas klasifikimit si e tillë;

d) Kredia është vlerësuar si e humbur nga inspektorët e mbikëqyrjes dhe në raportin e inspektimit, është kërkuar fshirja e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga këshilli drejtues i bankës. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

Klasifikimi i aktiveve të tjera, i angazhimeve të financimit të dhëna

Neni 19

Aktivet e tjera, si edhe angazhimet e dhëna të financimit klasifikohen në dy kategori:

1. standarde ose të rregullta;

2. të dyshimta ose me probleme.

Politikat e klasifikimit të aktiveve të tjera dhe të angazhimeve të dhëna të financimit në kategorinë “të dyshimta ose me probleme”, si edhe madhësia e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga humbja e vlerës së tyre, miratohen nga këshilli drejtues i bankës.

Madhësia e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga rënia e vlerës së aktiveve të tjera, të cilat janë të ndjeshme ndaj lëvizjeve të normave të interesit, nuk duhet të jetë më e vogël se interesi i përlogaritur.

Regjistrimet në kontabilitet kryhen sipas të njëjtës metodologji të përcaktuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje.

Raportimi

Neni 20

Bankat bëjnë klasifikimin e kredive dhe të aktiveve të bankës dhe llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve, të paktën një herë në tre muaj.

Ato hartojnë dhe paraqesin në Bankën e Shqipërisë formularët bashkëlidhur kësaj rregulloreje (formularët nr.2 dhe nr.3 janë pjesë përbërëse të sistemit raportues të unifikuar, ndërsa formularët 4, 5 dhe 6 raportohen çdo tre muaj në Departamentin e Mbikëqyrjes).

Neni 21

Banka e Shqipërisë mund të kërkojë në çdo kohë nga bankat të dhëna shtesë dhe analitike, mbi mënyrën e administrimit të rrezikut të kredisë dhe të krijimit të fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë.

Raste të veçanta

Neni 22

Manualët e miratuara nga këshilli drejtues i bankës përmbajnë rregulla të veçanta në përputhje me rregulloren “Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur”.

Kreditë ndaj “personave të lidhur” vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga këshilli drejtues i bankës.

Dispozita përfundimtare

Neni 23

Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë zbaton nenet 44 dhe 45 "Për shkeljet dhe dënimet" të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 24

Rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë" miratuar me vendimin nr.13, datë 21.2.2001 dhe ndryshimi i bërë me vendimin nr.32, datë 8.5.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohen.

Neni 25

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim Cani

Formulari 1
TË DHËNA PËR TEPRICËN E KREDISË SË KLIENTIT

		Periudha e vlerësimit			
Nr.		31.3.....	30.6.....	30.9....	31.12.....
1	Sfera e aktivitetit				
2	Forma e pronësisë				
3	Qëllimi i dhënies të kredisë				
4	Lloji i kredisë (sipas afatit)				
5	Detyrimi në garanci dhënë bankës				
6	Shuma totale e papaguar :				
	- kryegjëja				
	- interesi				
7	Pozicioni financiar i huamarrësit :				
	- i besueshëm , i mirë				
	- jo i besueshëm				
	- jo i kënaqshëm				
	- i keqësuar				
	- i falimentuar				
8	Sigurimi i kredisë				
	- i mjaftueshëm , i siguruar mirë				
	- i pamjaftueshëm , jo i siguruar mirë				
9	Ripagimi i kryegjësë dhe pagimi i interesit :				
	- i paguar në afatin e maturimit				
	- nuk është paguar për 1-30 ditë				
	- nuk është paguar për 31-90 ditë				
	- nuk është paguar për 91-180 ditë				
	- nuk është paguar mbi 181 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 1-30 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 31-90 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 91-180 ditë				
	- kësti nuk është paguar për 181-360 ditë				
	- kësti nuk është paguar mbi 361 ditë				
10	Numri i ristrukturimit të kredisë				
11	Klasifikimi i kredisë :				
	- kredi standarde , hua dhe paradhënie të pakthyera në afat për klientin (kësti)				
	- kredi në ndjekje				
	- kredi nënstandarde				
	- kredi të dyshimta				
	- kredi të humbura				
12	Provigjone për kreditë (sipas afatit)				
13	Provigjone për garancitë e dhëna				

Formulari 2

FONDE REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NGA KREDITË

Tabela nr.1		Kryegjësja				Fonde rezervë për kryegjësë			
Nr.	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Angazhime të dyshimta	Norma për provigjone	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Angazhi me të dyshimta	Shuma
		1	2	3	4	5=1*4	6=2*4	7=3*4	8=5+6+7
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)				0.01				
2	Kredi në ndjekje				0.05				
3	Kredi nënstandarde				0.20				
4	Kredi të dyshimta				0.50				
5	Kredi të humbura				1.00				
6	TOTALI								

Tabela nr.2		Interesat e llogaritur			Fonde rezervë për interesat		
Nr	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Norma për provigjone	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Shuma
		1	2	3	4=1*3	5=2*3	6=4+5
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)			0.01			
2	Kredi në ndjekje			0.05			
3	Kredi nënstandarde			1.00			
4	Kredi të dyshimta			1.00			
5	Kredi të humbura			1.00			
6	TOTALI						

Tabela nr.3		Rimarrje e fondit rezervë për kryegjënë				Rimarrje e fondit rezervë për interesat			
Nr	Klasifikimi i kredisë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Angazhime të dyshimta	Shuma për kryegjënë	Kredi për klientelën	Kredi ndër bankare	Shuma për interesat	SHUMA
		1	2	3	4=1+2+3	5	6	7=5+6	8=4+7
1	Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat (kësti)								
2	Kredi në ndjekje								
3	Kredi nënstandarde								
4	Kredi të dyshimta								
5	Kredi të humbura								
6	TOTALI								

Formulari nr.3

FONDET REZEVË TË KRIJUARA NGA BANKAPËR MBULIMIN E HUMBJEVE NGA KREDITË

Numrat e llogarive	Emërtimi i llogarive	Teprica në fillim 1(+)	Shtimi i provigjoneve 2 (+)	Rimarrja e provigjoneve 3 (+)	Kreditë e fshira gjatë periudhës 4(-)	Korrigjime të bëra gjatë periudhës 5 (+ ose)	Teprica në fund të periudhës (6=1+2+3-4±5)
128							
198							
238							
248							
258							
268							
298							
3128							
3138							
3228							
418							
518							
528							
538							
551							
558							

Formulari nr.4

Kredia në valutë dhe flukset e fondeve të klientëve

Objekti i kredisë në valutë	Vlera e portofolit të kredisë në total	Vlera e portofolit të kredisë në valutë	Teprica e kredisë në valutë	Nr. i kredive të pamaturuara në valutë	Nr.i kredive në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë	Teprica e kredisë në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë
	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)			(000 lekë)
	(a)	(b)	(c)	(d)	(e)	(f)
Për tregti						
Për pasuri të paluajtshme						
Për zhvillim biznesi						
Kredi konsumatore						
Të tjera						
Totali						

Kursi i këmbimit i përdorur në plotësimin e formularit : 1 EUR = _____ Lekë ; 1 USD = _____ Lekë] Burimi : _____

Sqarim:

- Në kolonën (e) do të regjistrohet numri i kredive për të cilat, sipas bankës, klienti nuk i gjeneron të ardhurat kryesore të tij në valutë

Formulari nr.5

Kredia në valutë dhe cilësia

Objekti i kredisë në valutë	Teprica e kredisë në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë.	Në euro	Kredi me probleme	Kursi mesatar i këmbimit (EUR/Lek) në momentin e disbursimit të plotë	Totali i provigjioneve për kredinë në euro	Në USD	Kredi me probleme	Kursi mesatar i këmbimit (USD/Lek) në momentin e disbursimit të plotë	Totali i provigjioneve për kredinë në USD	Totali i provigjioneve
-----------------------------	--	---------	-------------------	---	--	--------	-------------------	---	---	------------------------

(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)
'(1) =									(10) = (5)
(2) + (6)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	+ (9)

Për tregti									
------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Për pasuri të paluajtshme									
---------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Për zhvillim biznesi									
----------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Kredi konsumatore									
-------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Të tjera									
----------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Totali									
--------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Kursi i këmbimit i përdorur në plotësimin e formularit: 1 EUR = _____ Lek ; 1 USD = _____ Lek
Burimi : _____

Sqarim :

Kolonat e këtij formulari (nga numri (2) deri në numrin (10)) plotësohen në funksion të natyrës së kredisë të paraqitur në kolonën (1).

Në kolonën (1) shenohen vlerat që merren nga kolona (e) e formularit nr.4." Kredia në valutë dhe flukset e fondeve të klienteve"

Kolona (3) mbushet sipas kuptimit të termit "kredi me probleme", përkufizuar në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë".

Për kreditë që janë disbursuar me disa këste, kursi i këmbimit në momentin e disbursimit të plotë, do të jetë kursi i këmbimit mesatar i ponderuar me pjesët e kredisë të disbursuara, në momentin e disbursimit.

Formulari nr.6

Kredia në valutë dhe struktura e kohëzgjatjes

Objekti i kredisë në valutë	Teprica e kredisë në valutë, ku klienti nuk kryen aktivitet në valutë*	Në euro	Mbetur në maturim deri në 1 vit	Mbetur në maturim deri në 5 vjet	Mbetur në maturim mbi 5 vjet	Në USD	Mbetur në maturim deri në 1 vit	Mbetur në maturim deri në 5 vjet	Mbetur në maturim mbi 5 vjet
		(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)	(000 lekë)
	(1) = (2) + (6)	(2)=(3+4) + (5)	(3)	(4)	(5)	(6)=(7)+(8)+(9)	(7)	(8)	(9)
Për tregti									
Për pasuri të paluajtshme									
Për zhvillim biznesi									
Kredi konsumatore									
Të tjera									
Totali									

 Kursi i këmbimit i përdorur në plotësimin e formularit : 1 EUR = _____ Lek ; 1 USD = _____ Lek
 Burimi : _____

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Rr. Qemal Stafa, kati i parë, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE 1500

Doli nga shtypi më 21.7.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë